

LIGJ
Nr.7603, datë 10.9.1992

PËR DËRGIMIN PA SHPËRBLIM TË KOPJEVE TË DETYRUARA TË
SHTYPSHKRIMEVE BIBLIOTEKAVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të gjitha entet botuese dhe mjetet e informimit publik shtetërore ose private, që e kanë qendrën në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të dërgojnë pa shpërblim, brenda 1 muaji nga dita e tërheqjes prej shtypshkronjës, në Bibliotekën Kombëtare dhe në bibliotekën shtetërore të rrethit ose të bashkisë ku ushtrojnë veprimtarinë, nga 5 kopje për çdo botim që shtypet brenda ose jashtë territorit të vendit, duke paguar edhe shpërblimin postar.

Neni 2

Kopjet e detyruara që u dërgohen bibliotekave përfshijnë të gjitha llojet e botimeve e shtypshkrimeve si libra, gazeta, revista, broshura, buletine, albume, dispenca, harta, atlase, pllakate, parrulla, mjete figurative në ndihmë të nxënësve, afishe të veprimtarive të rëndësishme, fletëpalosje, me përjashtim të shtypshkrimeve të karakterit administrativ ose për përdorim të brendshëm të ministrive, institucioneve dhe ndërmarjeve.

Neni 3

Moszbatimi i këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobënga 3000 deri në 10 000 lekë për çdo shtypshkrim të padërguar në biblioteka. Gjoba për shkeljet e detyrimeve ndaj Bibliotekës Kombëtare jepen nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë e të Sporteve dhe për bibliotekat e rretheve ose bashkive nga përgjegjësi i seksionit kulturës të këshillit të rrethit ose të bashkisë. Kundër dënimit me gjobë mund të bëhet ankesa brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit përkatësisht te ministri i Kulturës, i Rinisë dhe i Sporteve dhe te kryetari i këshillit të rrethit ose kryetari i bashkisë, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 4

Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.4945, datë 10.3.1972, shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi më 1.10.1992.

Shpallur me dekretin nr.302, datë 21.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.